REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Notere-SHPRESA GJOCI
NIPT-NR.61621011S
Tel-0682071706

NR. 9885 REP
NR. 6880 KOL

# KONTRATE DHURIMI

**Kuotat e kapitalit themeltar te shoqërisë " ALBA FASHION CONFESSION " SH.P.K.**

Sot me datën 24/ 12.2019( dy mije e nëntëmbëdhjetë)unë noterja Shpresa GJOCI, me seli ne rrugën S. Delvina- TIRANE, vërtetoj se u paraqiten para meje personalisht:

**PALA DHURUESE :**
**MERIMANDO RIZA SULA,** i datëlindjes 14.11.1982, lindur dhe banues në Elbasan, i pajisur me kartë identifikimi me nr. personal I21114014J, ne mungese, i përfaqësuar me prokure te posaçme nr. 1200 rep, nr. 552 kol, date 27.06.2019 nga zj.MARJANA KUJTIM SULA, e datëlindjes 26.06.1982, lindur dhe banuese ne Elbasan, madhore, me zotësi të plote juridike për t e vepruar, pajisur me pasaportë personale nr. BA 4355387.

**PALA PRANUESE:**
GENTIAN PLLUMB PERÇI, i datëlindjes 29.07.1994, lindur dhe banues në Elbasan, madhor, me zotësi te plote juridike për t e vepruar, pajisur me pasaporte personale për identifikim me nr. BR 0902456.

**BAZA LIGJORE**: Ligji "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" dhe Ligji "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit te biznesit" dhe ligji nr.110.2018"per noterinë".

Palët e mësipërme kërkuan nga unë noter ja përpilimin e këtij akti dhurimi te kuotave te kapitalit te shoqërisë" **ALBA FASHION CONFESSION " SH.P.K. "** si me poshtë vijon:

**Pala dhuruese , duke mbajtur përgjegjësi te plote ligjore deklaron se:**

Jam ortak ne shoqërinë ALBA FASHION CONFESSION " SH.P.K. , me seli ne Bradashesh Elbasan, pajisur me numër nipti biznesi L 82620202I, dhe zotëroj kuota kapitali ne ketë shoqëri ne masën 50%, me vlere kapitali ne para 50.000, 00 leke, me numër pjese 1,00, fakt qe vërtetohet nga ekstrakti i regjistrit tregtar për te dhënat e subjektit, date 24.12.2019.

Konform vullnetit tim te lire, deklaroj se : Kuotat e kapitalit qe unë zotëroj ne ketë shoqëri, ne masën 50%, me te gjitha te drejtat dhe detyrimet financiare, pa kufizim, ja dhuroj zotit. GENTIAN PLLUMB PERÇI.

**Unë pala pranuese zoti.** GENTIAN PLLUMB PERÇI, **duke mbajtur përgjegjësi te plote ligjore deklaroj se:**

Për sa u deklarua me sipër nga pala dhuruese jam plotësisht dakord ,dhe nuk kam asnjë pretendim ligjor.

Marr përsipër te gjitha te drejtat dhe detyrimet ligjore e financiare dhe ato te prapambetura n.q.s. ka, te pjesës qe me dhurohet , te kuotave te kapitalit te shoqërisë **ALBA FASHION CONFESSION " SH.P.K.**

Me ketë veprim te bere ne mes palëve, zhvishet nga e drejta e pronësisë se kapitalit te shoqërisë ALBA FASHION CONFESSION " SH.P.K. pala dhuruese Zoti. MERIMANDO RIZA SULA, dhe pjesa e tij takuese i kalon zotit.Gentian Perçi.

Me ketë veprim te bere ne mes palëve, kuotat e kapitalit te shoqërisë janë te ndara konkretisht:

50%, te kuotave te kapitalit te shoqërisë ALBA FASHION CONFESSION " SH.P.K. janë ne pronësi te zotit.GENTIAN PERÇI ,dhe 50% te kuotave te kapitalit te shoqërisë ALBA FASHION CONFESSION " SH.P.K. janë ne pronësi te ortakut tjetër te shoqërisë zotit. ELDI ÇALA.

Pales pranuese, I lind e drejta ligjore QKB qe te bej ndryshimet përkatës e ligjore mbi bazën e kësaj kontrate dhurimi.

Sa me sipër u lexua me zë te larte, u gjend konform vullnetit te lire te palëve te mësipërm, u nënshkrua prej tyre dhe ne baze te ligjit u ligjërua nga unë notere.

PALA DHURUESE
**MERIMANDO RIZA SULA,**
I përfaqësuar me prokurë nga:

Marjana Sula

PALA PRANUESE

GENTIAN PERÇI

NOTERE
SHPRESA M GJOCI

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

RBS
Regjistri i Barrëve Siguruese

## REZULTATET E KËRKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te Kerkimit: | D-2019122411114025 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 24.12.2019 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 11:11:40AM |
| Lloji i Kerkimit: | |
| Numri i Dokumentit: | D-400-271-58274 |
| Referenca e Perdoruesit: | |

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0**

ALBA FASHION CONFESSION SH.P.K.

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE R.B.S. TIRANË - ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRËS
ZYRA E NOTERISË ELBASAN

Dt 27.06.2019

Nr. 1200 Rep
Nr 552 Kol

# PROKURË E POSAÇME

Në Elbasan , sot më datë 27/06/2019 ( Njëzet e shtate qershor dymijë e nentëmbëdhjetë ), para meje noterit Klevis Q.KOSOVA anëtar I Dhomës së Noterisë DURRËS me seli në LAGJA "5 Maj" Rruga "Kozma Naska" , pallati 747 ,Elbasan u paraqit personalisht :

## I PËRFAQËSUARI

**Merimando Sula** i biri i Riza ,i lindur 14.11.191982 ne Mollas Elbasan dhe banues ne Elbasan me zotësi te plotë juridike për të vepruar e identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit Nr 027380715 dhe Nr personal I 21114014 Je leshuar ne date 24.08.2009 .

*I cili më kërkoi redaktimin e një*

## PROKURË TE POSAÇME

Bazuar ne nenin 64-78 te Kodit Civil
Si me poshte vijon:

Unë i nënshkruari Merimando Sula me anë te kësaj prokure emëroj si përfaqësuesen time të posaçme zj **Marjana Sula** ,e bija e **Kujtim** i lindur me 26.06.1982 në Cërrik Elbasan dhe banuese në Elbasan e identifikuar nepermjet letërnjoftimit me **Nr 027856303** dhe Nr personal **I 25626274 I** i leshuar me date 09.11.2009 shtetase shqiptare me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

E cila ka te drejte qe në emër dhe për llogarine time te përmbushe këto tagra:
Përfaqësuesja e zgjedhur me anë te këtij akti përfaqësimi, në mënyrë te shprehur ka tagër **përfaqësimi** për te më përfaqësuar pranë:

a.) **Zyres Noteriale dhe ka te drejte te revokoje ,apo te ndryshoje cdo kontrate te meparshme shitje me rezerve ligjore me Nr 2106 Rep dhe Nr 924 Kol date 03.05.2018 te lidhur para noteres M.Sadushaj Tirane ,si dhe çdo kontrate tjeter te kujtdo forme ligjore ose kontrate porosie,hipotekimi,prenotimi,marrje kredie apo huaje , apo te ardhshme te cdo forme qofte ajo ,ku une kam marre persiper te drejta dhe detyrime .**

b.) Te me perfaqesoje prane çdo zyre noteriale te Republikes se Shqiperise duke pasur tager **disponimi** dhe te nenshkruaje kontrata te shitblerjes apo kontrata shitje me rezerve ligjore, deklaratave per permbushjen e kushtit ne rastet e shitjes me rezerve,kontratave te

hipotekimit vetem per rastet e garantimit te detyrimeve te bleresve te pasurise time qe do te financohet apo kreditohet nga banka te ndryshme, si dhe cdo veprim tjeter juridik te nevojshem per kete qellim per pasurine e paluajtshme te siperpermendur, duke i caktuar vete perfaqesuesi ime kushtet e kontrates te shitjes, çmimin, menyren e likuidimit,monedhen,si dhe te caktoje llogarine ku do te kaloje vlera e çmimit te shitjes se pasurise , ku ne jemi ne cilesine e pales shitese ne pasurine e llojit "Apartament", me NR. 102/21+4-14, me siperfaqe .totale 70.60 m$^2$ (shtatedhjete pike gjashtedhjete meter katror) ZK 3266, Vol.26 Faqe. 171 Adresë ne Tirane .

c.) Pranë çdo personi juridik publik dhe privat,pranë çdo enti shteteror dhe privat si dhe çdo organi te administratës ne nivel qendror dhe lokal,dhe çdo zyre te pushtetit lokal pa pasur asnje kufizim ne të gjithe territorin e Republikës së Shqipërisë duke pasur te drejte te kryeje çdo veprim juridik ,administrativ dhe financiar pa asnje kufizim ne llojin dhe qellimin e tij me te gjitha te drejtat e perfaqesimit te parashikuara ne ligj duke pasur te drejte te dorezoje ,kerkoje ,aplikoje ,terheqe,dhe nenshkruaje çdo lloj dokumentacioni lidhur me te drejtat dhe detyrimet e personit tim.

d.) Prane çdo banke te nivelit te dyte si dhe te Bankes Qendrore ne Republiken e Shqiperise duke patur te drejte per te nenshkruar cfaredo lloj dokumentacioni ligjor,per te kryer çdo veprim finaciar ne leke shqiptare apo ne valute te huaj te kujdo shteti pa pasur kufizim ne shumen apo vleren e saj,duke pasur te drejte terheqje dhe depozitimi vlerash monetare pa pasur kufizim ne sasine dhe vleren e saj,per transferim ne favor te te treteve ne formen e likujdimit te faturave apo detyrimeve te mia ,si dhe per leshimin dhe pranimin e ceqeve dhe nenshkrimin e tyre per te trete dhe firmosjen e aplikimeve per kredi dhe hua nga bankat.

e.) Prane cdo Dege te Tatimeve ne Republiken e Shqiperise,Drejtorive rajonale te Sigurimeve Shoqerore,Te Zyrave te Punes,inspektoriatit te Punes,OSSHE-ve,etj te doganave shqiptare qofshin keto kufitare apo brendshme si dhe cdo agjensie doganore per te kryer cdo veprim administrativ dhe finaciar lidhur me veprimet doganore te importimit dhe eksportimit,per mallrat ne emer te shoqerise duke pasur te drejte te drejte te nenshkruaje cdo deklarate importi,eksporti,qe permabn llojin,sasine cilesine dhe treguesit e tjere te nevojeshme per kryerjen e importit eksportit dhe transitit sipas legjislacionit doganor ne fuqi.

**f.)** Prane çdo zyre noterie per te nenshkruar cdo lloj akti noterial pa asnjë kufizim, për të nënshkruar kontrata shërbimi,furnizimi ,kontrata kredie ,dhe cdo lloj kontrate tjeter .

g.) Pranë cdo gjykate te cdo niveli si dhe te gjitha shkallet e tjera te gjyqesorit per çdo çeshtje civile administrative cilido qofte pozicioni procedurial si padites i paditur apo pale e trete per te kryer cdo veprim te nevojshem juridik dhe administrativ per te realizuar qellimin e ketij perfaqesimi.

Perfaqesuesja ime ka te drejte zgjedhe mbrojtes duke i dhene atij me prokure cdo te drejte qe me njeh Kodi Civil,dhe i Procedures Civile ,te nenshkruaje padi kunderpadi te beje ankim ne cdo gjykate apeli,rekurs ne Gjykaten e Larte te beje prapsime te beje shtesa e ndryshime te objektit te padise te kundershtoje vendimet e ndermjetme dhe perfundimtare te kerkoje pezullim te ceshtjes te kerkoje marrjen e provave te ndryshme dhe te reja te kerkoje perjashtim te trupes gjyqesore te kerkoje rivendosjen ne afat ,te kërkoje ekzekutimin e titujve ekzekutive të detyrueshem nga persona private dhe shoqëri qe ngarkon ligji si dhe ti ankimoje vendimet e tyre duke kryer çdo veprim tjeter ligjor per ekzekutim e titujve ekzekutive dhe te vendimeve te Gjykatave.

Përfaqësuesja ime ka tagra të pakufizuara në volumin e tyre dhe kjo prokure lëshohet për një periudhe kohe te pakufizuar deri ne përmbushjen e qëllimit për te cilin eshte lëshuar dhe per sa kohe nuk eshte revokuar me nje akt te dytë te te njëjtës formë sipas përcaktimeve te nenit 76 te Kodit Civil.

*Ky akt u mbajt ne kater kopje dhe unë noteri Klevis Q.Kosova pasi u binda per identitetin e paleve te cilet me konfirmuan se e lexuan dhe kuptuan permbajtjen e aktit e legalizoj aktin sipas nenit 63 të ligjit 110 dt 20.12.2018 " Për noterinë".*

I PËRFAQËSUARI

MERIMANDO SULA

NOTER

Klevis Q.KOSOVA